



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:013300

Datë: 11.04.2024

Numri i dokumentit: 05560497

PKR.nr.134/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, në përbërje nga gjyqtari Alban Ajvazi, kryetar i trupit gjykues dhe gjyqtarëve profesionistë Avni Sylja dhe Sulltane Hoti, anëtarë të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Leutrim Hoti, në çështjen penale kundër të pandehurit F.K, për shkak veprës penale Vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së dhe veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, PP/I.nr.26/2023 të datës 09.03.2023, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datën 13.03.2024, në prezencën e Prokurores së shtetit Dulina Hamiti, të akuzuarit F.K me mbrojtësin e tij av. Hamdi Ibrahimimi dhe të dëmtuarit-dëshmitarit G.B me përfaqësuesin e tij av. Bekim Kafexholli, me datë 15.03.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 11.04.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

F.K, nga i ati H. dhe nëna F., e gjinisë Sh., i lindur më ..., në fshatin ..., Komuna e Malishevës, me vendbanim në lagjen ..., në Prishtinë, me nr. personal ..., i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Në bazë të nenit 363 par.1, pika 1.2 të KPPRK-së lidhur me nenin 12, par.1 dhe 2 të KPRK-së

LIROHET NGA AKUZA

I

Sepse:

I pandehuri F.K, me dt. 14.01.2023, rreth orës 17:15 minuta, në rrugën “Hyzri Talla” në Prishtinë, deri sa ishte me veturën e tipit “Nisan Note”, ngjyrë e bardhë, pas një mosmarrëveshje në komunikacion me të dëmtuarin G.B, ashtu që i pandehuri F.K, me dashje me qëllim ka tentuar

ta privoj nga jeta të dëmtuarin G.B, në atë mënyrë që i pandehuri e ka sulmuar fizikisht të dëmtuarin me mjetë të rrezikshëm të mprehtë me thikë, duke e goditur rreth 6 herë në pjesët e ndryshme të trupit, në shpinë, në dorën e majtë dhe në këmbë, e më pas e ka goditur me veturën e tipit “Nisan Note”, ngjyrë e bardhë, me pjesën e përparme të veturës të dëmtuarin G.B duke e rrëzuar për tokë, me ç’rast i ka shkaktuar plagë prerëse, shpuese në regjionin e majtë i dorës, në regjionin e shpinës pran boshtit kurrizor majtas, në bërrylin e dorës së majtë, në kofshën e majtë, në regjionin nën shpatullën e majtë, me ç’rast i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore me dëmtim të përkohshëm të shëndetit të dëmtuarit G.B, dhe më pas i pandehuri F.K është larguar nga vend i ngjarjes dhe thikën ka arritur ta fsheh,-

- Me këtë kishte për të kryer veprën penale Vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së.

Sepse ka rrethana që përjashtojnë përgjegjësin penale, përkatësisht veprimet e të pandehurit janë në kuadër të mbrojtës së nevojshme.

Në bazë të nenit 363 par.1, pika 1.1 të KPPRK-së;

LIROHET NGA AKUZA

II

Sepse:

I pandehuri F.K me datë kohë dhe vend të përshkruar si në dispozitivin e parë të kësaj aktakuze, në veturën e tij ka mbajtur në kontroll dhe posedim të pa autorizuar një thikë-brisk, të cilën e ka përdorur si mjet për kryerjen e veprës penale të përshkruar si në dispozitivin parë të kësaj aktakuze, të cilën thikë e ka mbajtur në kontroll, dhe posedim të paautorizuar dhe në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm për armët,-

- Me këtë kishte për të kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Sepse vepra me të cilën i akuzuari akuzohet nuk përbën vepër penale.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore, të kësaj gjykate.

I dëmtuari-dëshmitari G.B, me vendbanim në lagjen ..., në Prishtinë, ka hequr dorë nga kërkesa pasurore-juridike.

A r s y e t i m

Rrjedha e procedurës:

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda ka ngritur Aktakuzën PP/I.nr.26/2023 të datës 09.03.2023, kundër të akuzuarit F.K, për shkak veprës penale Vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së dhe veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Kjo gjykatë me aktvendimin nën shenjën PKR.nr.134/23 të datës 20.11.2023, ka refuzuar kërkesën për hedhjen e aktakuzës dhe kundërshtim të provave të ushtruar nga mbrojtësi i të akuzuarit F.K, av. Hamdi Ibrahim.

Gjykata lidhur me këtë çështje penale, me datën 20.02.2024, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor, ku kanë prezantuar prokurorja e shtetit Dulina Hamiti, i akuzuari F.K me mbrojtësin e tij av. Hamdi Ibrahim dhe përfaqësuesi i të dëmtuarit-dëshmitarit av. Bekim Kafexholli, ku i akuzuari në bazë të nenit 319 të KPPRK-së, është udhëzuar me të drejtat e tij ligjore dhe pas leximit të aktakuzës, i akuzuari është udhëzuar në bazë të nenit 321 par.1 të KPPRK-së, mbi të drejtat për deklarimin e pranimit apo mos pranimit të fajësisë, ku i akuzuari është deklaruar i pafajshëm lidhur me veprat penale Vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së dhe Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Në prani të këtyre rrethanave, Gjykata ka vazhduar me rrjedhën e shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale, është dhënë fjala hyrëse e palëve, gjithashtu për vërtetimin e gjendjes faktike lidhur me këtë çështje penale juridike, në kuptim të dispozitave të nenit 7 dhe nenit 360 të KPPRK-së, ka dëgjuar të dëshmitarët: V.GJ dhe S.H.GJ, gjithashtu në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 13.03.2024 ka dëgjuar të dëmtuarin-dëshmitarin G.B, është bërë administrimi i provave materiale, është dhënë mbrojtja e të akuzuarit si dhe është dhënë fjala përfundimtare e palëve.

Fjala përfundimtare e palëve:

Prokurorja e shtetit Dulina Hamiti në fjalën e saj përfundimtare ka deklaruar se: është vërtetuar se i pandehuri ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet, kjo është vërtetuar nga deklaratë e të dëmtuarit G.B e po ashtu edhe nga dëshmia e dëshmitareve të cilat janë dëgjuar nga shqyrtimi gjyqësor, si dhe nga administrimi i provave materiale e po ashtu nga raporti mjekësor ligjore i datës 31.01 2023 e përpiluar nga eksperti mjeko Ligjor Flamur Blakaj, e ku është konstatuar se i dëmtuari është goditur me mjet të mprehte edhe atë në disa pjesë të trupit, ku i pandehuri me dashje e ka goditur të dëmtarin me thike duke i shkaktuar plage prerëse shpuese në regjionin e majte i dorës në regjionin e shpinës pranë boshtit kurrizor majtas, në bërrylin e dorës së majte në kofshën e majte, në regjionin nën shpatullën e majte pra i akuzuari me dashje 6 here e ka goditur të dëmtuarin G.B duke i shkaktuar lëndime trupore me pas i pandehuri këtë thike ka arritur ta

fsheh, i pandehuri në polici ka pranuar se e ka përdorur brisken-thiken e ka pranuar qe e ka hedhur pas ngjarjes e ne deklaratën e dhen edhe ne prokurori është munduar të ndryshoj deklaratën duke u munduar ti shmanget përgjegjësisë penale ndërsa ne shqyrtim gjyqësor thotë me çelsa te veturës kështu qe edhe nga deklarimi i te dëmtuarit i cili deklaroj se është goditur me thike disa here ne disa pjese trupit andaj nga te gjitha provat dhe dëshmimit e administruara ne shqyrtim gjyqësor dhe nga vet mbrojtja e të pandehurit e dhënë në polici, i cili e ka pranuar se ka goditur te pandehurin andaj ne mënyre te plote është vërtetuar se i pandehuri F. ka kryer veprat penale për te cilën është akuzuar, andaj mbetem pranë aktakuzës dhe i propozoj gjykatës qe F.K ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit dhe me rastin e marrjes se dënimit si rrethane renduese ta merr këmbulsinë e tij për kryerjen e këtyre veprave penale, peshën e rende dhe gjithashtu pasojën e shkaktuar nga këto veprime si dhe veprimet me qëllim qe ta mshef mjetin e kryerjes se veprës penale – thikën.

Përfaqësuesi i të dëmtuarit, av. Bekim Kafexholli në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se: në cilësinë e palës se dëmtuar, pala e dëmtuar heq dore nga kërkesa pasurore juridike dhe ndjekja penale.

Mbrojtësi i të akuzuarit F.K, av. Hamdi Ibrahimimi në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se: gjate këtij shqyrtimi gjyqësor nga provat materiale të prezantuara dhe nga deklarata e vet të dëmtuarit si dëshmitar është arritur që të vërtetohet plotësisht e kundërta e asaj çka prokurori i shtetit pretendon në aktakuzë nuk është kontestuese se personi i cili prokurori i shtetit në këtë çështje penale e ka prezantuar si palë të dëmtuar në kohën dhe në vendin e theksuar në aktakuzë të ketë pësuar lëndime të lehta trupore me dëmtim te përkohshëm të shëndetit. Por çështja është se perse u shkaktuan këto lëndime trupore nga i mbrojturi im.

Gjate shqyrtimit gjyqësor janë dëgjuar dy dëshmitarë dhe i dëmtuari ne cilësinë e dëshmitarit rikujtoj se ne lidhje me këtë ngjarje ishin krijuar dy momente me rendësi që kanë reflektuar edhe me tutje ne rrjedhën e kësaj procedurë penale momenti i pare është kur pas ngjarje dëgjohe dy dëshmitare S.H.GJ dhe V.GJ, këto dy dëshmitare kanë dhënë deklaratë inkriminuese për të mbrojturin time deri nate shkalle sa ky edhe pasi qe e ka sulmuar fillimisht te dëmtuarin me veture edhe ka tentuar ta godas, ishin këto deklarata qe i dhanë orientim hetimeve dhe përfundimit te mbrojturit time ne masën e paraburgimit, momenti i dyte është kur zbulohet video-incizimi dhe merret në pyetje i dëmtuari në cilësinë e dëshmitarit. I dëmtuari ne deklaratën e tij dhen ne cilësinë e dëshmitarit nga momenti i pare e deri ne ketë shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se ishte ai qe me veturën e tij i del përpara te mbrojturit time, i shkoj te vetura, i hapi derën e veturës te mbrojturit time herën e pare e shtrëngoj për koke dhe kështu rezulton qartësisht se me ketë veprim duke e pengua frymëmarrjen i rrezikoj edhe jetën, nuk i mjaftoj vetëm njëherë por ketë veprim e përsëriti edhe një here. Këto veprime i konfirmoj i dëmtuari edhe në shqyrtim gjyqësor, i mbrojturi im ne vetëmbrojtje sikurse deklaroj sot ka përdorur një mjet të cilin me herët e ka quajtur si brisk të cilin e mbante ne çelësa, pretendimi i prokurorit te shtetit se i mbrojturi im e ka fshehur mjetin me te cilin është vet mbrojtur nuk është asgjë tjetër vetëm tentim te mbrojmë një aktakuze krejtësisht te paqëndrueshme për faktin e thjesht se te mbrojturit time askush asnjëherë nuk ja ka kërkuar qe te dorëzoj ketë brisk. Veprimet e të mbrojturit tim konsiderohen se janë marrë ne mbrojtje te nevojshme dhe prokurori i shtetit provën materiale e cila e sqaron gjendjen qartë e përdor kundër te pandehurit apo tenton ta përdor.

I akuzuari F.K ka deklaruar se: e përkrahi fjalën përfundimtare të mbrojtësit dhe nuk kam çfarë të shtoj tjetër.

Provat e administruara:

Në shqyrtimin gjyqësor publik gjykata konform nenit 7 të KPPRK-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrje të vendimit të ligjshëm, me vëmendje dhe përkushtim maksimal profesional dhe përkujdesje të njëjtë vërtetoi faktet kundër të akuzuarit si dhe ato në favor të tij duke i mundësuar të akuzuarit shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të mbrojtjes dhe me ndërgjegje vlerësoi çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera, gjithashtu gjykata për vërtetimin e gjendjes faktike lidhur me këtë çështje penale juridike, në kuptim të dispozitave të nenit 7 dhe nenit 360 të KPPRK-së, ka dëgjuar të dëmtuarin-dëshmitarin G.B, dëshmitarët: V.GJ dhe S.H.GJ si dhe ka administruar provat materiale: raportin e ekspertizës mjeko- ligjore e përpiluar nga eksperti Mjeko Ligjore Dr. Flamur Blakaj të datës 01.02.2023 për të dëmtuarin G.B, raportin analitik nga policia e Kosovës NJHP-Prishtinë mbi analizimin e video-incizimeve lidhur me rastin 2023-AD-0137, i datës 16.01.2023, së bashku me foto dokumentacionin dhe shikimi i dy (2) DVD me video-incizime me numër të rastit 2023-AD-0137.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 20.02.2024, në cilësinë e dëshmitares është dëgjuar V.GJ, e cila ka deklaruar se: lidhur me ngjarjen e datës 14.01.2023 rreth orës 17:15 kemi qene duke u kthyer ne shtëpi se bashku me S., kemi qenë duke hy në banesë, i kemi parë dy vetura të ndalura para neve qe e kishin bllokuar rrugën dhe krejt çka kam parë është se i dëmtuari ka qenë jashtë veturës me një vajzë të vogël, ku i njëjti i'u ka ofruar veturës së të pandehurit e cila veturë ka qenë pas veturës së të dëmtuarit janë fjalos me njëri tjetrin dhe i pandehuri e ka goditur veturën e të dëmtuarit, ku ky i fundit është rrezuar në tokë dhe pastaj është ngritur në këmbë, dhe i pandehuri është larguar vrullshëm me veturën e tij nga vendi i ngjarjes, pastaj kanë ardhë polici dhe kam dhënë deklaratë në veturën e tyre.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 20.02.2024, në cilësinë e dëshmitares është dëgjuar S.H.GJ, e cila ka deklaruar se: ditën kur ka ndodhur rasti kam qenë me vajzën vlera dhe i kam parë dy vetura te ndalura para neve, vetura para nesh ka qenë ngjyrë e bardh dhe para saj ka qenë një veturë me ngjyrë të mbyllur e cila është ndalur para veturës së bardhë dhe nga aty shoferi i kësaj veture me ngjyrë të mbyllur (i dëmtuari) ka dal nga vetura dhe ka shkuar të vetura e bardh dhe unë nuk kam vërejtur diçka tjetër përveç kur e kam parë të njëjtin të rrezuar në tokë dhe është ngritur menjëherë në këmbë dhe në ato momente ka dalë një fëmijë nga vetura e të dëmtuarit.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 13.03.2024, në cilësinë e të dëmtuarit-dëshmitarit është dëgjuar G.B, i cili ka deklaruar se: me datën 14.01.2023 rreth orës 17:15 kam qenë rruga B, pasi që jam rreshtuar për tu kthyer në anën e majtë ka fakulteti teknik ne semafora, pasi që është hap semafori jam nis, mirëpo semafori tjetër hapet për këmbësor të njëjtën kohe dhe aty ka qenë një grua e moshuar duke kaluar rrugën dhe unë i kame dhenë përparësi këmbësorit, vetura pas meje është irituar dhe ka bërë me drita me siguri se ai nuk e ka parë këmbësorin dhe nuk e ka dite arsyen e ndaljes time, pasi që kemi filluar lëvizjen i pandehuri ka dale përpara duke me tejkalar me veture dhe ka filluar të frenoj, ka vazhdua dy here ose tre here frenimin dhe e shpejtoj vozitjen, unë kam vazhduar ti shkoj prapa tij deri tek qendra tregtare ne Breg Diellit, para qendrës tregtare e ka ndalur veturën dhe unë e kam tejkalar, i kam thënë vajzës time rri në veturë dhe kam shkuar tek vetura e cila është ndalur e cila mbeti mbrapa meje, i kam trokit ne xhame, ai nuk e ka hapur as xhamin as derën ne atë rast unë e kam hapur derën e veturës dhe i kam thënë çka të bërë në komunikacion që frenove dhe kjo ka ndodhur shume shpejt dhe i pandehuri ka tentuar me dalë nga vetura, mirëpo unë e kam kapur për koke dhe i njëjti me ka goditur nga krahu

në këmbë, mbrapa dhe mandej kam kuptuar se ka qenë me thikë mjeti që më ka goditur, pastaj i kam thënë tash po merremi me polici, ai ka vazhduar dhe është larguar i pari nga vendi i ngjarjes dhe ka ardhë policia dhe ndihma e shpejtë pasi që kam qenë i lënduar dhe më kanë dërguar në emergjencë. Pas ngjarjes më ka kontaktuar babai i F. dhe më ka kërkuar falje dhe është shqetësuar për shëndetin tim.

Gjykata lidhur me këtë çështje penale administroi edhe provat materiale siç janë: raporti i ekspertizës mjeko - ligjore i përpiluar nga eksperti mjeko ligjore Dr. Flamur Blakaj të datës 01.02.2023 për të dëmtuarin G.B, raporti analitik nga policia e Kosovës NJHP-Prishtinë mbi analizimin e video-incizimeve lidhur me rastin 2023-AD-0137, i datës 16.01.2023, së bashku me foto dokumentacionin dhe shikimi i dy (2) DVD me video-incizime me numër të rastit 2023-AD-0137.

Nga raporti i ekspertizës mjeko - ligjore i përpiluar nga eksperti mjeko ligjore Dr. Flamur Blakaj të datës 01.02.2023, vërtetohet se i dëmtuari G.B ka pësuar lëndime të lehta trupore me dëmtime të përkohshme të shëndetit, të cila janë shkaktuar nga veprimi mekanik i mjetit me maje, që paraqesin plagë prerëse, shpuese në regjionin e majtë i dorës, në regjionin e shpinës pranë boshtit kurrizor majtas, në bërrylin e dorës së majtë, në kofshën e majtë dhe në regjionin nën shpatullën e majtë.

Nga raporti analitik nga policia e Kosovës NJHP-Prishtinë mbi analizimin e video-incizimeve lidhur me rastin 2023-AD-0137, i datës 16.01.2023, së bashku me foto dokumentacionin, vërtetohet momenti kur kalojnë i pandehuri me veturën me ngjyrë të bardhë dhe i dëmtuari me veturën me ngjyrë të hirit, të cilët lëvizin në drejtim të fakultetit teknik dhe nga kamerat e sigurisë të bankës NLB Bank në rr. "Hyrzi Talla" të datës 14.01.2023, rreth orës 17:16:16 h, shihet ku i dëmtuari G.B del nga vetura e tij e shkon tek dera e veturës së të pandehurit F.K, ku ja hap derën dhe aty fillon përlëshja fizike, ku i pandehuri nuk mund të dalë nga vetura dhe në ato momente e sulmon me thikë të dëmtuarin.

Nga DVD-1 me numër të rastit 2023-AD-137, PP.I.nr.26/2023, në video-incizimin e datës 14.01.2023, ora 17:06:04, shihet se: *i dëmtuari G.B është me veturën e tij ngjyrë të hirit mbrapa veturës së të pandehurit F.K i cili është përpara me veturën e tij ngjyrë të bardhë dhe i dëmtuari i qëndron nga pas në distancë të afërt dhe duke e blinduar me drita veturën e të pandehurit.*

Nga DVD-2 me numër të rastit 2023-AD-137, PP.I.nr.26/2023 të datës 19.01.2023, në video-incizimin e datës 14.01.2023, ora 17:16:16, kamera 4, shihet se: *i dëmtuari G.B me veturën e tij ngjyrë të hirit e tejkalon të pandehurin F.K i cili është me veturën e tij të bardhë dhe i dëmtuari ndalet në rrugë dhe del nga vetura e tij, shkon tek vetura e të pandehurit dhe menjëherë i'a hap derën e veturës dhe fillon ta godas dhe përlëshen fizikisht me njëri tjetrin për 17 sekonda dhe pastaj i dëmtuari mundohet ta mbyll derën e veturës së të pandehurit, mirëpo e njëjta nuk mbyllet, dhe i dëmtuari prapë e hap dhe e godet dhe mban për koke të njëjtin, ndërsa i pandehuri në vetëmbrojtje shihet duke e goditur me dorën e djathtë, por nuk shihet se çfarë ka në dorë dhe pastaj i dëmtuari i'a mbyll derën e veturës, shkon në veturën e tij dhe largohet, pas tij largohet edhe i pandehuri.*

Pas deklarimit të dëmtuarit, dëshmitarëve dhe administrimit të provave materiale, i akuzuari ka paraqitur mbrojtjen e tij në shqyrtimin gjyqësor.

I akuzuari F.K, në mbrojtjen e tij të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 13.03.2024 ka deklaruar se: ditën kritike pasi që i dëmtuari më ka ndjekur me veturën e tij, unë kisha me vazhdu rrugën për në tophane, në lagjen ku jetoj, por duke parë presionin që më është bërë nga i

dëmtuari, kur e kam kaluar fakultetin teknik nuk kam vazhduar drejtë me u ndal në semafora për shkak se kam deshtë me shmang problemin dhe jam nisur në drejtim të qendrës tregtare, ku në atë moment i dëmtuari më ka tejkalu dhe unë s'kam mundur të vazhdoj as mbrapa, as para dhe kam qendru brenda në veturë, ku i dëmtuari ka ardhë ma ka hap derën e veturës time dhe më ka goditur dhe pasi që më ka mbajtur për koke, ka qenë duke me u nxanë fryma dhe në atë moment me një mjetë që e mbaj të vendosur në çelësa jam mbrojte duke e goditur të dëmtuarin, kjo ka zgjatë për disa sekonda, pastaj i dëmtuari është larguar dhe unë s'kam pasur qëllim që ta sulmoj pasi që as nuk jam dal prej veturës, as nuk e kam ndjekur mbrapa.

Gjetjet e gjykatës:

Faktet jo kontestuese:

Për gjykatën nuk është kontestuese se ditën kritike i pandehuri dhe i dëmtuar kanë pasur mosmarrëveshje në komunikacion me njëri tjetrin, se i dëmtuari e ka ndjek me veturë të pandehurin dhe atë nga rruga B, ku janë kthyer te fakulteti teknik e deri tek qendra tregtare në breg të diellit, ku i dëmtuari me veturën e tij i kishte dalë përpara të pandehurit dhe ja kishte bllokuar rrugën, pasi që i dëmtuari i'a kishte bllokuar rrugën të pandehurit, kishte shkuar te vetura e të njëjtit, i'a kishte hapur derën dhe kishte filluar që ta godas, më pastaj i pandehuri ishte mbrojtur. Gjithashtu nuk është kontestuese që nga kjo përleshje i dëmtuari ka pësuar lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshëm.

Faktet e lartcekura nuk kanë qenë kontestuese në mes të palëve. Përveç kësaj, faktet e tilla vërtetohen edhe nga dëshmia e të dëmtuarit, nga provat materiale të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe nga i pandehuri.

Faktet Kontestuese:

Kontestuese dhe e pavërtetuar deri në fund të shqyrtimit gjyqësor, mbeti rrethana se pasi që i pandehuri ishte sulmuar nga i dëmtuari, i njëjti të ketë vepruar në mbrojte të nevojshme si dhe a ka pas për qëllim ta privoj nga jeta të dëmtuarin.

Faktet kontestuese gjykata i ka zgjidhur pas administrimit të provave materiale dhe personale gjatë shqyrtimeve gjyqësore.

Sa i përket veprës penale të paraparë si në dispozitivin I të këtij aktgjykimi, Vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, gjykata nga dëgjimi i të dëmtuarit-dëshmitarit G.B, dhe nga provat materiale si: raporti i ekspertizës mjeko - ligjore i përpiluar nga eksperti mjeko ligjore Dr. Flamur Blakaj të datës 01.02.2023 për të dëmtuarin, raporti analitik nga policia e Kosovës NJHP-Prishtinë mbi analizimin e video-incizimeve lidhur me rastin 2023-AD-0137, i datës 16.01.2023, e konkretisht nga shikimi i dy (2) DVD me video-incizime me numër të rastit 2023-AD-0137, të marra nga vendi i ngjarjes si dhe nga deklarimi i të pandehurit, vlerëson se nuk përmbushen e elementet e veprës penale Vrasje në tentativë, për vetë faktin se i dëmtuari e ka përcjellë të pandehurin me veturë dhe atë nga rruga B, ku janë kthyer te fakulteti teknik e deri tek qendra tregtare në breg të diellit, ku kjo shihet edhe në video-incizim kur i dëmtuari, i del përpara veturës të pandehurit, duke e ndal veturën para tij, duke i'a pa mundur të pandehurit që të vazhdojë rrugën dhe pasi që i'a kishte bllokuar rrugën të njëjtit, kishte dalë nga vetura e tij

dhe kishte shkuar tek vetura e të pandehurit dhe i'a kishte hapë derën e veturës dhe kishte filluar menjëherë që ta sulmoj të pandehurin.

Gjykata vlerëson se nga këto veprime nuk përmbushet figura e veprës penale vrasje në tentativë, pasi që për tu përmbushur kjo figurë e kësaj vepre penale, duhet të jetë se kush do që me dashje privon apo tenton ta privoj nga jeta duke e goditur në pjesët vitale personin, ku mund të shkaktoj vdekjen, e që në rastin konkret i pandehuri pasi që është sulmuar nga i dëmtuari i njëjti është mbrojtur, ku nga video incizimi shihet se i pandehuri mbrohet duke e goditur me dorën e djathtë të dëmtuarin, me qëllim të zbrapsjes së sulmit i cili ka qenë i atëçastshëm, e nga mbrojtja e tij të dëmtuarit i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin, ku asnjë prej këtyre goditjeve nuk ka qenë në pjesën vitale të trupit të dëmtuarit, gjykata vlerësoi se mjetin të cilin e ka përdor i pandehuri për tu mbrojtur nuk ka qenë mjetë proporcional me sulmin, mirëpo nga rrethanat e rastit vlerësoj se sulmi nga i dëmtuari ka qenë i pa pritur, andaj në këto rrethana i pandehuri nuk ka mundur të dijë se i dëmtuari nuk ka edhe mjete të tjera të rrezikshme me vete për faktin se pasi që i dëmtuari i'a hap derën e veturës, të njëjtin e sulmon menjëherë duke e goditur dhe kapë për koke, duke i'a ulur kokën poshtë, ashtu që i'a ka pa mundësuar shikimin të pandehurit dhe në këto rrethana i njëjti nuk ka pasur kohë dhe mundësi të analizojë ngjarjen, pasi që e gjithë kjo ngjarje ka ndodhë shumë shpejtë, për disa sekonda, kjo vërtetohet edhe nga deklaratat e të dëmtuarit.

Mbi bazën e këtyre veprimeve gjykata vlerëson se kemi të bëjmë me mbrojtje të nevojshme nga neni 12 par.1 dhe par.2 të KPRK-së, e cila mbrojtje ka qenë e domosdoshme për të zbrapsur sulmin, e kundërligjshme, reale dhe e atëçastshme ndaj vetes dhe karakteri i mbrojtjes ka qenë në proporcion me shkallën e rrezikut që është paraqit sulmi, e në rastin konkret gjykata vlerëson se sulmi ka qenë i kundërligjshëm, real dhe i atëçastshëm dhe i pandehuri ka vepruar në mbrojtje të nevojshme për të zbrapsur sulmin, pasi që i pandehuri me vete ka poseduar një brisk në çelësa, ku me të njëjtin e ka goditur të dëmtuarin dhe me të cilat goditje i pandehuri e ka bërë me qëllim të zbrapsjes së sulmit dhe këto goditje nuk ishin të natyrës që të privojnë nga jeta të dëmtuarin, pasi që lëndime i ka marrë në krahë, kofshë dhe pas tyre shihet i dëmtuari i'a mbyll derën e veturës së të pandehurit dhe shkon në veturën e tij dhe largohet nga aty. Andaj gjykata në këto rrethana vlerëson se veprimet e të pandehurit të kryer në mbrojtje të nevojshme nuk është vepër penale.

Ndërsa që sa i përket veprës penale të paraparë si në dispozitivin II të këtij aktgjykimi, Mbajtja ne pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, gjykata vlerësoi se duke u mbështetur edhe në ligjin Ligjin Nr. 05/L -022 të datës 25.07.2015 për armë, përkatësisht në neni 2, pika 1.24 ku thuhet se “*armë e ftohtë - çdo mjet që mund të përdoret për sulm apo për shkaktim të lëndimeve trupore duke përdorë forcë fizike nga sulmuesi në rastet kur ato mbahen, në tubime publike, në objekte publike apo në vende të ngjashme...*”, në këtë rast nuk kemi të bëjmë me këtë vepër penale, pasi që briskun që i pandehuri e ka mbajtur ka qenë vetura e tij, e që konsiderohet vend privat dhe të njëjtin e ka përdor për tu mbrojtur, duke zbratur sulmin e atëçastshëm dhe të kundërligjshëm nga vetja, gjykata vlerëson se për tu formësuar figura a kësaj vepre penale arma e ftohtë-birsku duhet të ishte mbajtur vende publike, institucione

shtetërore apo të ngjashme dhe në këtë rast nuk përmbushen elementet e figurës së kësaj vepre penale.

Gjykata ka vlerësuar edhe deklaratat e dëshmitarëve V.GJ dhe S.H.GJ, për të cilat gjykata gjeti se të njëjtat janë në kundërshtim të plotë me gjendjen faktike, konkretisht deklarinimin e të dëmtuarit dhe me video incizimin, pasi që të njëjtat në shqyrtim gjyqësor kanë deklaruar se pas përlëshjes, e kanë parë të pandehurin duke e goditur me veturë të dëmtuarin me ç'rast i njëjti është rrëzuar, ndërsa nga video-incizimi, deklarimi i të dëmtuarit dhe i të pandehurit vërtetohet dhe shihet shumë qartë se është e kundërta e asaj çfarë kanë deklaruar dëshmitarët, që pasi që i dëmtuari parakalon të pandehurin me veturë, e ndalë veturën dhe shkon te vetura e të pandehurit i'a hap derën dhe menjëherë fillon ta godas dhe ta mbaj për koke dhe kur fillon të mbrohet i pandehuri, i dëmtuari i'a mbyll derën dhe largohet nga aty, andaj një deklarinim i tyre i pa saktë dhe imagjinar.

Gjykata vlerësoi pretendimet e prokurorisë, por e njëjta nuk arriti që t'i argumentoj me fakte dhe prova bindëse para gjykatës elementet e veprave penale me të cilën ngarkohet i akuzuari, ngase nga provat e administruara nuk u gjet se në veprimet e të akuzuarit formësohen elementet qenësore subjektive dhe objektive të atyre veprave penale, të cilat i vihen në barrë sipas aktakuzës, andaj nisur nga të gjitha këto që u thanë trupi gjykues pasi analizoi dhe vlerësoi provat personale dhe materiale, nuk gjeti se në veprimet e të akuzuarit formësohen elementet e veprave penale Vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së dhe Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, andaj në mungesë të provave, e në bazë të dispozitave ligjore, të akuzuarin e liroi nga akuza.

Në këtë rast gjykata në aplikim të nenit 3 par.2 të KPPRK-së, mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite i interpreton në favor të akuzuarit, e që në rastin konkret të gjitha mëdyshjet e paraqitura në vlerësim të gjendjes faktike e të cilat nuk u vërtetuan përtej dyshimit të bazuar mirë, i mori në favor të akuzuarit.

Prandaj sipas vlerësimit të gjykatës në rastin konkret me provat e propozuara dhe të zbatuara në shqyrtimin gjyqësor nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet.

Shpenzimet e procedurës:

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, është marrë në bazë të nenit 453, par.1 të KPPRK-së.

Mbi bazën e të dhënave si më lart dhe në bazë të nenit 12, par.1 dhe 2 të KPRK-së dhe në bazë të nenit 363, par.1, pika 1.1 dhe 1.2 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINE
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr.134/23, datë 11.04.2024**

G j y q t a r i

Alban Ajvazi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.